



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Drejtoria e Arsimit Parauniversitar

Nr. 101/.....Prot.

20

Tiranë, më 30.12.2013



MIRATOHET

MINISTRI

LINDITA NIKOLLA

PROGRAMET E ARSIMIT BAZË

(Për klasat e shansit të dytë)

LËNDA: HISTORI

KLASA I-V

Tiranë

Dhjetor 2013

I. TË PËRGJITHSHME

Lënda e historisë për klasat e shansit të dytë, në ciklin fillor do të zhvillohet në klasën e katërt dhe të pestë me një orë në javë, gjithsej 30 orë vjetore për secilën klasë, sipas planit mësimor të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit.

Në klasën e katërt nxënësit gjatë studimit të lëndës së historisë, e emërtuar "Hapat e parë në histori" do të aftësohen për të ndërtuar konceptet e para historike, si: vazhdimësia, ritmet e ngjarjeve historike, koordinatat e kohës dhe të hapësirës, kohëzgjatja, shndërrimet, faktet, shkaqet, pasojat, si dhe shprehje të thjeshta të cilat lidhen ngushtë me konceptin shumë të rëndësishëm të kronologjisë. Në kuadrin e studimit të lëndës, përfshihen edhe disa nga zhvillimet më të rëndësishme shoqërore, ekonomike, shkencore, politike dhe fetare të shoqërisë njerëzore, duke filluar studimin nga mjedisi më i afërt shoqëror që është familja, për të kaluar gradualisht më pas në studimin e ngjarjeve më të rëndësishme për Shqipërinë, Evropën e botën më gjerë.

Në klasën e pestë, programi i lëndës "Vendlindja" është ndërtuar rreth integritetit të temave të shkencave shoqërore nëpërmjet lëndëve të gjeografisë, historisë, ekonomisë, trashëgimisë historiko-kulturore e mbrojtjes së mjedisit. Në lëndën e vendlindjes nxënësit do të aftësohen në zhvillimin e aftësive dhe koncepteve historike, gjeografike, kulturore, ekonomike përmes harmonizimit të elementëve të relievit, zhvillimeve ekonomiko-sociale, riteve dhe traditave, historikut të qytetit apo fshatit ku nxënësi jeton dhe mëson.

1. SYNIME TË LËNDËS

Programi i lëndës së historisë gjatë ciklit fillor, përkatësisht klasa e katërt "Hapat e parë në histori" dhe e pestë "Vendlindje", synon të vendosë bazat e formimit qytetar të nxënësve përmes kultivimit dhe edukimit të ndjenjave kombëtare dhe të atdhedashurisë. Programi synon të nxitë nxënësit të respektojnë larminë kulturore të shoqërisë dhe të drejtat e njeriut.

Nxënësit aftësohen të kuptojnë lidhjet si brenda ashtu dhe ndër periudha e shoqëri të ndryshme, të respektojnë origjinën historike dhe të kuptojnë dobinë e larmisë etnike dhe kulturore të shoqërisë.

Ky program synon zhvillimin e një sërë aftësish të domosdoshme për të nxënësit gjatë gjithë jetës. Me anë të kuptimit të kronologjisë, nxënësit aftësohen të kuptojnë vijimësinë e ngjarjeve në të kaluarën dhe marrëdhënien shkak-pasojë. Ata aftësohen të kuptojnë rolin e kohës në ndryshueshmërinë e njerëzve dhe të shoqërisë, duke njohur disa nga ndryshimet më të rëndësishme shoqërore, ekonomike dhe politike që kanë ndodhur deri në ditët e sotme. Me anë të studimit të njerëzve e të shoqërisë përgjatë historisë, nxënësit pajisen me aftësinë e

kërkimit, aftësinë e interpretimit historik, aftësinë e organizimit të njohurive dhe të komunikimit të tyre në mënyra të ndryshme

2. LINJAT E PROGRAMIT

Të ndara sipas klasave, linjat dhe orët e sugjeruara jepen të përmbledhura në tabelat e mëposhtme.

Në klasën IV të ciklit fillor për klasat e shansit të dytë, lënda “Hapat e parë në histori” do të zhvillohet në 30 javë mësimore me 1 orë në javë.

30 javë x 1 orë / javë = 30 orë

NR.	LINJAT	SASIA E ORËVE
1.	Hyrje në lëndën e historisë	6 orë
2.	Fillimet e jetës njerëzore në tokë	6 orë
3.	Fillimet e jetës njerëzore në vendin tonë. Ndryshimi dhe vazhdimësia	4 orë
4.	Shqipëria, atdheu ynë	6 orë
Përsëritje, teste, punë praktike, ekskursione		8 orë

Në klasën V të ciklit fillor, për klasat e shansit të dytë, lënda “Vendlindja” do të zhvillohet në 30 javë mësimore me 1 orë në javë.

30 javë x 1 orë / javë = 30 orë

NR.	LINJAT	SASIA E ORËVE
1.	Përshkrimi i tipareve të qendrës tuaj (urbane ose rurale)	4 orë
2.	Popullsia (në qytetin ose fshatin tuaj)	4 orë
3.	Tiparet e mjedisit natyror (në qytetin ose fshatin tuaj)	4 orë
4.	Mjedisi natyror dhe jeta e njerëzve (në qytetin ose fshatin tuaj)	2 orë
5.	Historia e mjedisit rrethues (në qytetin ose fshatin tuaj)	5 orë
6.	Mbrojtja e mjedisit që na rrethon (në qytetin ose fshatin tuaj)	2 orë
Punë praktike		4 orë
Përsëritje, teste, ekskursione		5 orë

3. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

Çdo tematikë e programit zërthehet në objektivat përkatës. Objektivat përcaktojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që duhet të fitojë çdo nxënës në fund të secilës klasë. Të gjithë nxënësve duhet t'u jepen mundësi të barabarta për të arritur objektivat në fjalë. Të gjithë objektivat e të nxënësve grupohen në objektiva:

- të njohurive, ku nxënësit marrin njohuritë dhe mësojnë konceptet kryesore të lëndës së historisë, shkencave shoqërore dhe i përdorin ato në kontekste e situata të ndryshme;
- të aftësive, ku nxënësit zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të menduar në mënyrë kritike, për të kryer punë kërkimore, për të organizuar, interpretuar dhe komunikuar informacionin e përfutur, për të zgjidhur probleme të ndryshme, për të menduar në mënyrë krijuese, për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në grup, për të marrë vendime të mirinformuara;
- të qëndrimeve, ku nxënësit nxiten të formojnë dhe të mbajnë qëndrime individuale dhe në grup, bazuar në argumente, vlera dhe besime të përfutura gjatë edukimit, për të mirën e përbashkët të shoqërisë.

Orët mësimore

Programi i lëndës së historisë gjatë ciklit fillor të arsimit parauniversitar për klasat e shansit të dytë zbatohet në 60 orë mësimore, përkatësisht 30 orë mësimore në klasën e katërt për zhvillimin e lëndës “Hapat e parë në histori” dhe 30 orë mësimore në klasën V për zhvillimin e lëndës “Vendlindja”. Këto lëndë zhvillohen secila me 1 orë mësimore në javë (30 orë në vit).

4. METODAT E MESIMDHËNIES

Metodologjia e zbatimit në klasë të programit të lëndës së historisë luan rol thelbësor për përmbushjen e synimeve të këtij programi. Të nxënësve në këtë lëndë mund të realizohet vetëm me anë të pjesëmarrjes aktive të nxënësve në procesin e të nxënësve, në mënyrë që ata të kuptojnë, të përbrendësojnë, të vlerësojnë e të përdorin përmbajtjen e synuar për të ndërtuar mbi të njohuri e aftësi të reja në situata të ndryshme me të cilat do të përballen në të ardhmen. Edhe pse të nxënësve në mënyrë të pavarur mbetet i rëndësishëm, po aq rëndësi ka edhe dhënia e mundësive me anë të metodologjisë së mesimdhënies për të ndërvepruar me njëri-tjetrin dhe me mjedisin ku jetojnë. Për këtë, shkolla duhet të ofrojë një mjedis mbështetës e përkujdesës, ku të njihet e të vlerësohet kontributi i secilit nxënës.

Mësuesi duhet të zbatojë në klasë teknika aktive të mësimdhënies dhe të nxënësve. Ai duhet të organizojë aktivitete, të udhëzojë nxënësit për të marrë pjesë në to dhe të mundësojë pjesëmarrjen aktive dhe kuptimplote të nxënësve. Në këtë mënyrë nxënësit do të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë për të nxënësit e tyre, duke formësuar kështu aftësitë e para për të nxënësit gjatë gjithë jetës.

Metodologjitë e mësimdhënies duhet të përcaktohen bazuar sa në objektivat e programit, aq edhe në nevojat e veçanta të nxënësve. Përzgjedhja e metodave mësimore bëhet nga vetë mësuesi në përshtatje me veçoritë e temave të ndryshme mësimore. Një harmonizim i drejtë i këtyre metodave lehtëson realizimin e objektivave të lëndës të parashikuar nga programi mësimor.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies që mund të zbatohen gjatë një ore mësimi, janë të shumta. Si të tilla mund të përdoren shpjegimi, i cili mund të jetë i suksesshëm në të gjitha ato veprimtari të përbashkëta të mësuesit e nxënësve që synojnë të kuptuarit e njohurive elementare për zhvillimin në kohë e në hapësirë të dukurive e proceseve historike, mësimi zbulues nëpërmjet të cilit kalohet nga njohuritë elementare në përgjithësime, nga hipotezat në gjetjen e origjinës së dukurive, nga problemet e thjeshta në zgjidhjen e tyre, biseda, e cila do të ishte më e efektshme për ato tema ku nxënësit kanë njohuri paraprake të bollshme që fitohen nëpërmjet rrugëve të shumta të informacionit masiv, diskutimi që zgjidh problemin, punë në grupe, vizatime, konkurse, ekskursione të shoqëruara me veprimtari praktike, etj.

Metodat dhe teknikat fuqizojnë si të nxënësit ashtu edhe mësimdhënien duke shmangur të mësuarit pasiv dhe mekanik të nxënësve. Një harmonizim i drejtë i këtyre metodave lehtëson realizimin e objektivave dhe rezultateve mësimore të linjave të parashikuara në program.

Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe teknikave të lartpërmendura nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike. Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënësve në lëndën e Historisë dhe Vendlindjes ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësit.

Në funksion të procesit mësimor dhe arritjes së rezultateve mësimore, mësuesit të shfrytëzojnë mjetet e nevojshme didaktike, si: harta historike të përgjithshme apo tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, harta të mjedisit lokal, të dhëna statistikore sipas tematikave të parashikuara në program, materiale historikë të lidhura me aktualitetin shoqëror dhe në funksion të realizimit të mësimin, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD etj. Informacioni i siguruar përmes mjeteve të mësipërme duhet të përcillet te

nxënësit me një gjuhë të qartë, të thjeshtë, të kuptueshme, në përputhje me moshën e nxënësve.

Rekomandojmë që mësuesit të nxisin nxënësit për të krijuar portofolin e punëve të tyre i cili mund të përmbajë: albume, materiale mbi veprimtaritë e ndryshme dhe projektet krijuese, skica, harta, foto, të dhëna statistikore, materiale të punëve praktike etj;

Mësuesi duhet të tregojnë kujdes të veçantë që nxënësit të nxiten vazhdimisht të reflektojnë në mënyrë kritike mbi ecurinë e të nxënësve dhe punës së tyre në shkollë dhe të transferojnë ata çka kanë mësuar në situata jetësore brenda dhe jashtë shkollës.

Mundësia për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga përvojat e lëndës së historisë, ashtu si nga çdo lëndë tjetër në shkollë, duhet t'u ofrohet të gjithë nxënësve pa përjashtuar askënd për asnjë shkak. Mësimdhënia duhet të bazohet në interesin më të lartë të nxënësve dhe duhet të sigurojë trajtimin e barabartë me dinjitet e respekt të gjithsecilit.

5. VLERËSIMI

Vlerësimi është një aspekt i rëndësishëm i lëndës së historisë. Me anë të vlerësimit të vazhdueshëm, mësuesi ndjek nga afër ecurinë e nxënësve, si dhe vlerëson se sa të përshtatshme e të dobishme janë metodat e mësimdhënies që ai përdor.

Vlerësimi është një informacion i rëndësishëm që i shërben nxënësve për të ndjekur ai vetë ecurinë e tij në këtë lëndë, për të njohur anët e tij të forta dhe vështirësitë që has në këtë lëndë, në mënyrë që të punojë përkatësisht për përfundimin dhe kapërcimin e tyre.

Vlerësimi është një informacion i rëndësishëm edhe për prindërit, me anë të të cilit ata mund të ndihmojnë më mirë në edukimin e fëmijëve të tyre.

Vlerësimi i nxënësve duhet të nxjerrë në pah arritjet e tyre, në mënyrë që ata të inkurajohen të mësojnë me më shumë dëshirë. Ai duhet të konsiderohet si një mjet në ndihmë të nxënësve, i cili i ndihmon ata të njohin më mirë aftësitë e tyre në të nxënë.

Me anë të vlerësimit, mësuesi informohet rreth çfarë dhe si po mësojnë nxënësit, çka e ndihmon atë të planifikojnë mësimdhënien në vijim dhe të përgatisë materiale ose të rishikojë metodologjinë e mësimdhënies për t'iu përshtatur nevojave të nxënësve.

Vlerësimi i nxënësve në këtë lëndë duhet të realizohet jo vetëm në vazhdimësi, por edhe në harmoni me vlerësimin në të gjitha lëndët e tjera, duke iu përshtatur nevojave dhe kërkesave të vetë shkollës. Mësuesi duhet të vlerësojë arritjet e nxënësve sipas programit të planifikuar në këtë lëndë. Format e vlerësimit të nxënësve janë të larmishme. Ai mund të jetë sistematik (për çdo temë mësimore), periodik (në përfundim të çdo kapitulli), semestral dhe vjetor.

Vlerësimi mund të realizohet nëpërmjet teknikave të ndryshme, si:

Vëzhgimi: Mësuesi vlerëson ecurinë e nxënësve duke i vëzhguar ata gjatë punës individuale ose në grup, si dhe ndërveprimin e tyre gjatë veprimtarive të ndryshme në klasë dhe në shkollë.

Detyra dhe teste: Me anë të detyrave të ndryshme që mësuesi u jep nxënësve në klasë, ai arrin të vlerësojë si procesin e punës, ashtu edhe nivelin e të kuptuarit të njohurive të reja nga ana e nxënësve. Me anë të detyrave, mësuesi mund të vlerësojë edhe aftësinë e nxënësve për t'i përdorur dijet e marra në situata nga më të ndryshmet. Detyrat në klasë mund të jenë projekte në grup ose punë individuale. Detyrat në klasë duhet të jenë të tilla që të mundësojnë si arritjen e objektivave të programit, ashtu edhe vlerësimin nga ana e mësuesit për nivelin e arritjes së secilit nxënës.

Mësuesi mund t'i përdorë testet me shkrim në fund të linjave mësimore me qëllim matjen e rezultateve të arritjes së nxënësve për secilën linjë.

Dosja e nxënësit: Duke qenë se lënda e historisë dhe vendlindjes synon aftësimin praktik të nxënësve, sugjerohet që nxënësit të mbajnë një dosje vetjake me punimet që kryejnë gjatë veprimtarive në klasë. Në këtë dosje, nxënësit mund të mbledhin burimet historike të përdorura për të kuptuar ndryshimin dhe vazhdimësinë, të tilla si: fotografi, pamje ose skica, vizatimet e kryera në klasë, listën e objektivave në fillim të vitit, skenarin e shkruar për një pjesë teatrore, poezi ose tregime mbi tema të caktuara etj.

Projekte dhe punë praktike: Projektet dhe punët praktike i ndihmojnë nxënësit të përqendrohen në një temë të caktuar të programit, për shembull në njohjen e komunitetit ku ata jetojnë dhe studimin e tij në detaje. Me anë të tyre, mësuesi vlerëson aftësinë e nxënësve për të mbledhur informacion, për ta përpunuar dhe për ta prezantuar atë. Kjo mundëson vlerësimin e bashkëpunimit të nxënësve me njëri-tjetrin gjatë punës grup. Realizimi i një punë praktike apo projekti është tregues edhe i përgjegjësisë vetjake dhe të grupit, si dhe i përkushtimit dhe interesit të secilit nxënës.

Paraqitja dhe prezantimi i punimeve: Paraqitja dhe prezantimi i punimeve të ndryshme që nxënësit realizojnë gjatë lëndës së historisë dhe vendlindjes është për mësuesin tregues i aftësive të tyre për të mbledhur informacion, për ta përpunuar dhe për ta paraqitur atë. Gjatë paraqitjes dhe prezantimit të punimeve, nxënësit vlerësohen edhe për shtjellimin e këndvështrimeve të tyre, mbrojtjen e këtyre këndvështrimeve dhe mbajtjen e qëndrimit vetjak ose në grup ndaj një çështjeje të caktuar. Me anë të kësaj teknike mund të vlerësohen edhe aftësitë krijuese dhe ato të komunikimit që nxënësit kanë zhvilluar në shkollë.

Pavarësisht zgjedhjes nga ana e mësuesit të teknikave të vlerësimit, qofshin këto formale ose joformale, vlerësimi duhet domosdoshmërisht të synojë përmirësimin e përvojave të të nxënit të nxënësve.

II. OBJEKTIVAT DHE TEMATIKAT SIPAS LINJAVE

KLASA IV
HAPAT E PARË NE HISTORI
30 javë x 1 orë = 30 orë

LINJA 1

HYRJE NË LËNDËN E HISTORISË

Tematika

- Çfarë është historia. dhe pse e studiojmë atë? Lidhja e historisë me ngjarje, njerëz dhe vende të periudhave të kaluara.
- Matja e kohës në histori nga lashtësia deri në ditët e sotme. Lindja dhe përdorimi i kalendarit.
- Si mësojmë ne për jetën në të kaluarën? Burimet historike dhe rëndësia e tyre në paraqitjen e historisë.
- Klasifikimi i burimeve historike.
- Historia gojore dhe rëndësia e përdorimit të saj.
- Si të lexojmë një hartë ? Hartat historike.
- Ndryshimet dhe vazhdimësia e mënyrës së jetesës në familje: nga gjyshërit te nipërit.

Objektiva :

Nxënësit duhet :

- të jenë të aftë të krijojnë shkallën e kohës;
- të jenë të aftë të përdorin fjalorin e duhur, përfshirë shprehje të thjeshta, si, p.sh.: para, pas, afër, larg, i vjetër, i ri , javë, muaj, vit, dhjetëvjeçar, shekull, mijëvjeçar etj.;
- të lexojnë harta të thjeshta historike, duke shfrytëzuar për këtë edhe njohuritë e marra nëpërmjet lëndës së gjeografisë;
- të njohin dhe të kuptojnë nëpërmjet krahasimit, ndryshimet ndërmjet të kaluarës dhe të tashmes.

- të përvetësojnë në përputhje me përmbajtjen konceptet kryesore historike;
- të kuptojnë se e kaluara mund të paraqitet dhe të tregohet në forma e në mënyra të ndryshme dhe të jenë të aftë për të përdorur disa prej tyre;
- të kuptojnë që për ngjarje, dukuri, procese e figura historike ka interpretime të ndryshme;
- të jenë të hapur dhe të diskutojnë me njëri-tjetrin ose në grup për çështje të ndryshme mbi bazën e argumenteve dhe frymës së tolerancës e të mirëkuptimit;
- të përvetësojnë elemente të vëzhgimit që lidhen me përshkrimin e objekteve të thjeshta historike.

KOHA: 6 ORË

LINJA 2

FILLIMET E JETËS NJERËZORE NË TOKË

Tematika

- Si jetonin njerëzit e lashtë? Përhapja e tyre në të gjithë botën; organizimi shoqëror.
- Roli i gruas në zhvillimin e shoqërisë.
- Zhvillimi i artit dhe i kulturës.
- Besimi i njerëzve të lashtë.
- Shpikje të rëndësishme çuan përpara zhvillimin e njerëzimit.
- Zhvillimi i sotëm i shoqërisë dhe sfidat me të cilat përballet ajo.

Objektiva

Nxënësit duhet:

- të jenë të aftë të krijojnë shkallën e kohës për ngjarjet e studiuara;
- të jenë të aftë të përdorin fjalorin e duhur për periudhat e historisë së vjetër të shoqërisë njerëzore;
- të njohin dhe të kuptojnë ndryshimet që kanë ndodhur në zhvillimin e shoqërisë njerëzore;
- të njohin dhe të përshkruajnë rolin e gruas në zhvillimin e shoqërisë njerëzore;
- të njohin dhe të përshkruajnë rolin e shpikjeve më të rëndësishme, si dhe të artit e të kulturës në zhvillimin e shoqërisë njerëzore;
- të përvetësojnë, në përputhje me përmbajtjen, konceptet kryesore historike;
- të njohin disa nga format më të rëndësishme të paraqitjes të së kaluarës.

KOHA : 6 ORË

LINJA 3

FILLIMET E JETËS NJERËZORE NË VENDIN TONË. NDRYSHIMI DHE VAZHDIMËSIA

Tematika

- Banorët e lashtë të vendit tonë.
- Mënyra e jetesës dhe vendbanimet.
- Ndryshimi dhe trashëgimia.
- Jeta ekonomike dhe shoqërore.

Objektiva

Nxënësit duhet :

- të jenë të aftë të krijojnë shkallën e kohës për ngjarjet e studiuara, përfshirë këtu tregime apo ngjarje historike të lexuara apo të treguara, si dhe një pemë të thjeshtë gjenealogjike të familjes së tyre;
- të jenë të aftë të përdorin fjalorin e duhur në raport me periudhat kohore të studiuara.
- të njohin ndryshimin ndërmjet së tashmes dhe të kaluarës në jetën e tyre dhe të njerëzve të tjerë;
- të përshkruajnë ngjarjet më të rëndësishme që e kanë karakterizuar shoqërinë njerëzore në vendin tonë, si dhe pasojat e këtyre ngjarjeve;
- të njohin dhe të kuptojnë nëpërmjet krahasimit, ndryshimet ndërmjet së kaluarës dhe të tashmes, duke përcaktuar tiparet më kryesore të mënyrës së jetesës së popullit tonë;
- të përvetësojnë, në përputhje me përmbajtjen, konceptet kryesore historike përfshirë ato të ndryshimit dhe të vazhdimësisë;
- të kuptojnë dhe të demonstrojnë format dhe mënyrat e ndryshme të informacionit për njohjen e të kaluarës së vendit tonë;
- të jenë të aftë të përdorin hartat historike, duke transmetuar një informacion të qartë për zhvillimin e një ngjarjeje të caktuar;
- të përvetësojnë elemente të vëzhgimit që lidhen me përshkrimin e objekteve të thjeshta historike.

KOHA: 4 ORË

LINJA 4

SHQIPËRIA, ATDHEU YNË

Tematika

- Simbolet kombëtare të popullit shqiptar. Origjina, ndryshimi dhe vazhdimësia e tyre që nga lashtësia e deri në ditët tona.
- Festa kombëtare.
- Ndërtesat e rëndësishme ku realizohet qeverisja e Shqipërisë.
- Popullsia.
- Gjuha, arti, kultura dhe shkenca.

Objektiva

Nxënësit duhet :

- të rendisin kronologjikisht saktë ndryshimin dhe vazhdimësinë e simboleve kombëtare të popullit tonë;
- të njohin dhe të përshkruajnë ngjarjet më të rëndësishme të popullit tonë në fushat e artit, të kulturës dhe shkencës të përfshira në studim;
- të përvetësojnë, në përputhje me përmbajtjen, konceptet kryesore historike.
- të përshkruajnë simbolet tona kombëtare, si dhe origjinën e tyre;
- të kuptojnë që për ngjarje, dukuri, procese e figura historike, ka interpretime të ndryshme;
- të aftësohen për të përdorur në mënyrë të pavarur burime të ndryshme informacioni.

KOHA : 6 ORË

KLASA V
VENDLINDJA
30 javë x 1 orë = 30 orë

LINJA 1

PËRSHKRIMI I TIPAREVE TË QËNDRËS TUAJ (urbane ose rurale)

Tematika

1. Përshkrimi i hartës topografike të qendrës tuaj urbane ose rurale duke respektuar tiparet kryesore (plan-vendosja, pozita gjeografike).
2. Karakteristikat kryesore të banesave në qytetin ose fshatin tuaj.
3. Mjediset e punës në qytetin ose fshatin tuaj. Mjediset e gjelbra në qytetin ose fshatin tuaj.
4. Objektet ku kryhen veprimtaritë social-kulturore në qytetin ose fshatin tuaj. Mjedisë dhe objekte të tjera (arkeologjike, historike dhe argëtuese etj.)

Objektiva

Nxënësi duhet :

- të dallojë dhe të përshkruajë me fjalët e tij elementët kryesorë përbërës të qendrës urbane ose rurale në të cilën jeton;
- të shpjegojë hartën topografike të qendrës urbane ose rurale në të cilën jeton;
- të dallojë dhe të përshkruajë tiparet kryesore të banesave në qendrën urbane ose rurale në të cilën jeton;
- të përshkruajë rrugët kryesore, mjediset e punës, të argëtimit, të jetës sociale e kulturore të qytetit apo fshatit në të cilën jeton;

KOHA: 4 ORË

LINJA 2

POPULLSIA (në qytetin ose fshatin tuaj)

Tematika

1. Statistika për popullsinë në qytetin ose fshatin tuaj. Lindshmëria dhe vdekshmëria, rritja natyrore e popullsisë.
2. Mënyra e jetesës së grupeve të popullsisë në qytetin ose fshatin tuaj. Llojet kryesore të punëve në qytet/fshat. Veprimtaritë dhe qendrat kryesore prodhuese në qytetin ose fshatin tuaj.
3. Lëvizjet e popullsisë. Migrimet dhe emigrimet në periudha të ndryshme historike.
4. Përparësitë që ofron mjedisi unë në zhvillimin ekonomik.

Objektiva

Nxënësi duhet :

- të përshkruajë strukturën moshore të popullsisë në qytetin ose fshatin në të cilën jeton;
- të shpjegojë nga ana statistikore rritjen e popullsisë në qytetin ose fshatin në të cilën jeton;
- të përshkruajë mënyrën e jetesës së popullsisë në qytetin ose fshatin në të cilën jeton;
- të flasë për llojet e ndryshme të punëve që kryhen në qytetin ose fshatin e tij;
- të flasë për disa nga faktorët historikë e shoqërorë që kanë ndihmuar në zhvillimin e qytetit ose fshatit të tij.

KOHA: 4 ORË

LINJA 3

TIPARET E MJEDISIT NATYROR (në qytetin ose fshatin tuaj)

Tematika

1. Përbërësit e mjedisit natyror.
2. Relievi, tiparet e përgjithshme dhe elementët përbërës të tij.
3. Klima dhe mikroklimat e mjedisit natyror lokal.
4. Ujërat, bimësia dhe bota shtazore. Elementët përbërës të florës dhe faunës.

Objektiva

Nxënësi duhet :

- të përshkruajë relievin, tiparet e përgjithshme dhe elementet e veçanta në përbërje të tij;
- të përshkruajë klimën dhe të tregojë ndikimin e mikroklimës në mjedisin natyror ku jeton;
- të dallojë ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore në mjedisin e tij lokal;
- të dallojë dhe të përshkruajë veçantitë e botës bimore dhe shtazore dhe ndikimin e tyre në mjedisin tonë natyror.

LINJA 4

MJEDISI NATYROR DHE JETA E NJERËZVE (në qytetin ose fshatin tuaj)

Tematika

1. Ndikimi i mjedisit natyror lokal në jetën e njerëzve që jetojnë në të dhe ndikimi i veprimtarisë së njeriut në ndryshimin e mjedisit natyror.
2. Respektimi i mjedisit natyror dhe elementët përbërës të tij.

Objektiva

Nxënësi duhet:

- të përshkruajë ndikimin e mjedisit natyror lokal në veprimtarinë e njeriut dhe anasjelltas, ndikimi i njeriut në mjedisin natyror;
- të tregojë respekt për mjedisin natyror në të cilin jeton dhe elementët përbërës të tij.

KOHA: 2 ORË

LINJA 5

HISTORIA E MJEDISIT RRETHUES (në qytetin ose fshatin tuaj)

Tematika

1. Historiku i lindjes së qytetit ose fshatit tuaj. Tiparet etnokulturore të qytetit ose fshatit tuaj.
2. Institucionet lokale dhe historiku i tyre.
3. Pushtimet e huaja dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e qytetit ose fshatit tuaj.
4. Njohja me figurat më të rëndësishme në fushën e historisë, kulturës, arsimit etj. të qytetit ose fshatit tuaj, si dhe roli i qytetit ose fshatit tuaj në ngjarjet më të rëndësishme kombëtare.
5. Objekte të trashëgimisë kulturore në qytetin ose fshatin tuaj.

Objektiva

Nxënësi duhet :

- të përmendë dhe të flasë për historinë e vendlindjes, për ngjarjet më të rëndësishme dhe për figurat kryesore që kanë luajtur rol në historinë e qytetit ose fshatit të tij;
- të flasë për rolin e qytetit ose fshatit në ngjarje të rëndësishme kombëtare;
- të flasë për pushtimet e huaja dhe ndikimin e tyre në jetën dhe historinë e qytetit ose fshatit të tij;

- të përmendë institucionet kryesore qeverisëse në qytetin ose fshatin e tij dhe rolin e tyre në jetën e qytetit/fshatit;
- të përmendë objekte të trashëgimisë kulturore në qytetin apo fshatin e tij.

KOHA: 5 ORË

LINJA 6

MBROJTJA E MJEDISIT QË NA RRETHON

Tematika

1. Faktorët që ndikojnë në pakësimin e hapësirave të gjelbra në qytetin ose fshatin tuaj.
2. Roli i njeriut në mbrojtjen dhe dëmtimin e pasurive bimore e shtazore.

Objektiva

Nxënësi duhet :

- të dallojë faktorët që nxisin në kufizimin e hapësirave të gjelbra në qytetin ose fshatin e tij;
- të bëjë përpjekje për ndërgjegjësimin e komunitetit në mbrojtje të mjedisit dhe të bashkëpunojë në kuadrin e komunitetit me anëtarë të pushtetit lokal për ruajtjen e mjedisit.

KOHA: 2 ORË

PUNË PRAKTIKE SUGJERUESEⁱ

PUNË PRAKTIKE 1

INTERPRETIMI I HARTËS TOPOGRAFIKE TË MJEDISIT TUAJ LOKAL.

Synimi: Njohja dhe interpretimi i hartës topografike sipas kritereve të përcaktuara në legjendën e hartës për mjedisin tuaj lokal.

Tematika e sugjeruarⁱⁱ

1. Interpretimi i hartës topografike të mjedisit tuaj lokal.
2. Njohja me elementët përbërës të hartës topografike si: qendra historike, lagjet e banimit, rrugët, ndërtesat arsimore, kulturore etj.
3. Vendndodhja e hapësirave dhe kurorës të gjelbër, agrikulturës dhe pyjeve në mjedisin tuaj lokal .

Objektivat

Nxënësit duhet:

- të interpretojnë hartën topografike të mjedisit lokal ku jetojnë ;
- të dallojnë vendndodhjen e qendrave arsimore, kulturore, të qeverisjes, rrugët, pasuritë pyjore dhe hapësirës së gjelbër të mjedisit tuaj.

Mjetet e nevojshme:

Harta topografike në shkallën 1: 50.000, 1: 25000,
Tregues harte, laps i zi, lapsa me ngjyra, vizore, gomë.

KOHA: 2 ORË

PUNË PRAKTIKE 2

NJOHJA NË TERREN E MJEDISIT QË NA RRETHON

Synimi: Një vështrim i përgjithshëm i mbi tiparet e relievit të mjedisit tuaj lokal duke përfshirë klimën, llojet e shkëmbinjve, bimësinë, botën shtazore, mineralet dhe burimet e energjisë.

Tematika e sugjeruar

1. Njohja me elementët përbërës të relievit të mjedisit tuaj lokal.
2. Njohja me llojet e shkëmbinjve, tokave, maleve si pjesë e rëndësishme e relievit.
3. Njohja me klimën dhe mikroklimat që veprojnë në mjedisin tuaj lokal.
4. Njohja me bimësinë dhe botën shtazore të mjedisit tuaj lokal.
5. Njohja me ujërat, burimet minerare dhe të energjisë në mjedisin tuaj lokal.

Objektivat

Nxënësi duhet:

- të përshkruajë elementët përbërës të relievit përmes njohjes konkrete me terrenin;
- të ushtrohet në matjen e temperaturës, njohjen e bimësisë, të maleve etj.;
- të dallojë dhe të krahasojë bimësinë e tokave nga ajo e maleve, si edhe të dallojë vendburimet minerale e energjetike të mjedisit lokal.

Mjetet e nevojshme:

Harta memece fizike e relievit, album i botës bimore dhe shtazore të rajonit, lapsa të zinj, lapsa me ngjyra, barometër i thjeshtë për matjen e temperaturës, copa të vogla shkëmbinjsh etj.

KOHA: 2 ORË

PUNË PRAKTIKE 3

NJOHJA ME TRASHËGIMINË HISTORIKE DHE ETNO-KULTURORE SI PJESE PËRBËRËSE E MJEDISIT QË NA RRETHON

Synimi: Njohja nga afër me objektet e rëndësishme të mjedisit lokal në fushën e trashëgimisë historike, etno-kulturore, sociale si dhe përcaktimi i vendndodhjes së tyre në mjedisin që i rrethon.

Tematika e sugjeruar

1. Njohja me objektet historike të mjedisit tuaj lokal.
2. Njohja me ndërtesat e qeverisjes lokale apo qendrore që kanë vlera historike.
3. Njohja me objektet arkeologjike të mjedisit tuaj lokal .
4. Njohja me objektet kulturore dhe banesat karakteristike të mjedisit tuaj lokal.
5. Njohja me objekte të kultit fetar: kisha, xhami, teqe etj.

Objektivat

Nxënësi duhet:

- të dallojë dhe të veçojë sipas llojit edhe periudhave objektet e trashëgimisë historike, për shembull: objekte të karakterit arkeologjik; objekte të karakterit historik mesjetar etj. ;
- të dallojë si objekte historike, monumente që flasin për ngjarje të rëndësishme të lidhura me mjedisin e tij, figura historike si edhe banesa karakteristike;
- të përshkruajë historinë e qendrës historike të qytetit, vendndodhjen e objekteve kulturore;
- të dallojnë objektet e kultit fetar të mjedisit lokal.

Mjetet e nevojshme:

Udhëzues lokal (guidë), foto të objekteve historike dhe arkeologjike, fletore shënimesh, lapsa, aparat fotografik, albume .

KOHA : 2 ORË

PUNË PRAKTIKE 4

NJOHJA ME AKTIVITETET PRODHUESE DHE ORGANET E QEVERISJES LOKALE E QENDRORE TË MJEDISIT QË NA RRETHON.

Synimi: Njohja e nxënësve me qendrat ekonomiko-tregtare, industriale të mjedisit tuaj lokal. Dallimi i qendrave ekonomike nga ato qeverisjes lokale ose qendrore.

Tematika e sugjeruar

1. Njohja me qendrën apo rajonet tregtare të mjedisit tuaj lokal.
2. Njohja me qendrën apo rajonet industriale të mjedisit tuaj lokal.

3. Njohja me arteriet kryesore të rrugëve lokale dhe kombëtare të mjedisit tuaj lokal.
4. Njohja me objektet e qeverisjes lokale dhe qendrore.
5. Njohja me mjediset argëtuese dhe kulturore që i shërbejnë nxënësve në edukimin e tyre qytetar.

Objektivat

Nxënësi duhet:

- të dallojë dhe të përshkruajë veprimtarinë prodhuese ekonomike, industriale dhe tregtare;
- të përcaktojë vendndodhjen e rrugëve lokale e kombëtare, të ndërtesave të qeverisjes lokale e qendrore si edhe objektet e edukimit të nxënësve, parqe, biblioteka etj.

Mjetet e nevojshme:

Udhëzues lokal për qendrën ekonomike, tregtare dhe industriale. Fotografi të qendrave kryesore ekonomike, kulturore dhe argëtuese.

KOHA: 2 ORË

PUNË PRAKTIKE 5

RINDËRTIMI I HISTORIKUT TË MJEDISIT QË NA RRETHON

Synimi: Rindërtimi i historikut të mjedisit lokal, përmes disa objekteve që na japin një pamje më të plotë të historisë së tij. Të nxitet nxënësi të njohë dhe të respektojë traditën historike të mjedisit ku jeton dhe atij kombëtar

Tematika e sugjeruar

1. Përshkrimi i përgjithshëm i historisë së mjedisit tuaj lokal.
2. Njohja me foto të ndryshme për historinë e krijimit të mjedisit lokal, harta të vjetra etj.
3. Njohja me figura të rëndësishme të historisë të mjedisit tuaj lokal.
4. Njohja me objekte etnografike, vegla pune, veshje, zbukurime etj..
5. Njohja e historikut të familjes tuaj si pjesë përbërëse e mjedisit tuaj lokal.

Objektivat

Nxënësi duhet:

- të dallojë dhe të kërkojë gjetjen e sendeve ose veglave që mund të ndihmojnë në kuptimin e historisë së mjedisit;
- të ndërtojë një histori të shkurtër të mjedisit ku jeton përmes objekteve etnografike, veglave të punës, veshjeve ose figurave të ndryshme historike.

Mjetet e nevojshme:

Harta të vjetra të mjedisit lokal, foto të objekteve historike, veshje, objekte të trashëguara familjare etj.

KOHA: 2 ORË

ⁱ Për realizimin e programit “Vendlindja” mësuesi është i detyruar të zhvillojë dy nga pesë veprimtaritë praktike të sugjeruara në këtë program.. Përzgjedhja e tyre bëhet sipas dëshirave dhe interesave të nxënësve.

ⁱⁱ Mësuesi përzgjedh vetëm një nga temat e sugjeruara. Kjo është e vlefshme për secilën punë praktike të dhënë në program.